



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË, KOSOVO POLJE

Dt. 20.08.2025 283

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Komunitet të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-032, nenit 4.5 dhe 6 paragrafi 1,2 të Ligjit të Punës Nr.03/L212, neni 80 i ligjit për zyrtarët publik nr. 08/L-19, UA Nr.10/2018, UA Nr. 01/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Rregullores (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Komuna e Fushë Kosovës shpall:

K O N K U R S

Për themelimin e marrëdhënies së punës me afat të caktuar

1. Titulli i vendit të punës : Zyrtar Publik

Titulli i punës : Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët

Orari i plote i punës : 40 h në javë

Vendi i punës : Fushë Kosovë

Raporton tek : Drejtori i DKA-së dhe Kryetari i Komunës.

Mandati : 4 vjeçar

Pozita të lira : 1

Koeficienti : E 14 - 7.2

KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA PËR PRANIMIN E ZYRTARIT TË SHËRBIMIT PUBLIK:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët ;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsimin e përgjithshëm dhe normativit për arsimin profesional në fuqi;

- Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim(kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
- Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit/ses sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
- Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
- Të ketë të paktën pesë (5) vite përvojë pune si mësimdhënës/e në IEAA-AP;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në legjislacioni në fuqi

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

- Formulari i konkurrimit të jetë i plotësuar;
- Rezyrmeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftimi) kopje;
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit ;
Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
- Nëse kandidati/ja ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, nuk obligohet të dorëzoj dëshminë/certifikatën e trajnimit për udhëheqje në arsim.
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Vërtetimin e përvojës së punës në procesin edukativo-arsimor, nëse aplikuesi ka përvojë pune;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
- Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në formularët e Rregullores;
- Për pozitat e drejtorëve, kandidatët dorëzojnë konceptin e një plani zhvillimor të shkollës , i cili përshkruan konkretisht mënyrën dhe strategjinë përmes së cilës do të përmirësohet cilësia menaxheriale e shkollës.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të shkollës :

- Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- Hartimin e planit vjetor të punës dhe planin zhvillimor të institucionit arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimeve dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe qeshtje tjera që

kane te bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë në arsim;

- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikules;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmeve tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësim e performances dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me këshillin drejtues të institucionit edukativo- arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitareve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo- arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siq parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

KRITERET E VLERËSIMIT:

Testi me shkrim përbën 50% të peshës së vlerësimit të përgjithshëm të kandidatit/es

Testi duhet të përmbajë njëqind (100) pikë. Testi përmban 25 pyetje ku secila pyetje vlerësohet me më së shumti 4 pikë.

Testi me gojë/intervista, përbën 50% të peshës së vlerësimit të përgjithshëm të kandidatit/es.

Testi me gojë/intervista është e ndarë në dy pjesë:

1. Intervista e strukturuar me pyetje nga anëtarët e komisionit e cila përbën 30% të peshës së vlerësimit nga pjesa e testit me gojë/intervistës.
2. Portfolio profesionale e cila përbën 20% të peshës së vlerësimit nga pjesa e testit me gojë/intervistës.

Dëshmitë e ofruara në portfolio profesionale vlerësohen me pikë relevante si:

1. Shkallën/nivelin e kualifikimit (maksimum 5 pikë);
2. Notën mesatare gjatë studimeve themelore (maksimum 2 pikë);
3. Notën mesatare gjatë studimeve master (maksimum 2 pikë);
4. Realizimin e trajnimeve për programe trajnimi të cilat janë relevante për pozitën për të cilën aplikon (maksimum 3 pikë);
5. Dëshmi për kontributin në procese zhvillimore të arsimit të cilat janë relevante për pozitën për të cilën aplikon (maksimum 5 pikë);
6. Përvoja relevante e punës për pozitën për të cilën aplikon (maksimum 3 pikë).

Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai/ajo që i ka fituar së paku 70% të pikëve totale të vlerësimit të kombinuara nga testi me shkrim dhe testi me gojë/intervista.

AFATI I APLIKIMIT:

Data e njoftimit të konkursit **20.08.2025**

Afati për pranimin e aplikacioneve është tridhjetë (30) ditë kalendarike nga data **21.08.2025** deri më **19.09.2025**.

MËNYRA E APLIKIMIT

Formulari i aplikimit për punësim merret në zyrën pritëse në Objektin e Komunës së Fushë Kosovës, rruga “Tahir Zemaj” nr. 2 12000 çdo ditë pune, si dhe mund të shkarkohen nga ueb faqja SIMBNJ – konkursi.rks-gov.net.

MËNYRA E DORËZIMIT

Aplikacioni i nënshkruar së bashku me dokumentet e kërkuara dorëzohen në zyrën pritëse në objektin e Komunës.

Rezultatet shpallen në ëeb-faqen e Komunës si dhe në tabelën e shpalljeve.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit për aplikim dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në intervistë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim



Fatlum Berisha